



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 33 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe me aktin nr. 3444 prot., datë 28.06.2024, me anë të së cilës keni kërkuar që t'ju vendoset në dispozicion: 1) kopje e listës së notave për kandidatët fitues për formimin fillestar 2024/2025 profili gjyqtar që ju dispononi, 2) kopjet e listave të notave për kandidatët fitues që autoriteti publik KLGJ disponon për kandidatët gjyqtar që kanë fituar për formimin fillestar viti 2021/2022 dhe 2023, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i trajton të dhënat në lidhje me listat e notave për kandidatët fitues, profili gjyqtar në përputhje me parashikimet e Ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Në kuptim të Nenit 3, pika 1 e këtij ligji, këto të dhëna konsiderohen të dhëna personale duke qenë se identifikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose bëjnë të identifikueshëm kandidatët fitues në fjalë, në lidhje me një ose më shumë faktorë të veçantë për identitetin e tyre fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

Për sa më sipër, ju bëjmë me dije se në bazë të Nenit 6 të Ligjit 9887, si dhe Nenit 7 të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar nuk mund t'ju vendosim në dispozicion të dhënar e kërkuara nga ana juaj.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!